




REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PRESEDNIK



15.04.2020

Z. Albin Kurti,
Kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje

I nderuar z. Kurti,

Më datë 13.04.2020 (Ref.: 120/2020) kam pranuar një letër nga ju, ku u jeni referuar shkresave që ua kam dërguar juve në cilësinë e Kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje. Në këtë shkresë ju nuk keni propozuar kandidatin/en për Kryeministër, por as nuk keni refuzuar një gjë të tillë. Duke marrë parasysh kërkesat që ua kam përcjellë më datë 2 prill 2020 (Ref. 354, 02.04.2020) dhe më datë 10 prill 2020 (Ref. 354/1, 10.04.2020), përsëri ua rikujtoj se jam në pritje të përgjigjes suaj për të propozuar kandidatin/en për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës, pas mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë (Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 07-V-013, të datës 25.03.2020).

Ju rikujtoj që mandati im kushtetues më obligon që të garantoj funksionimin demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe sigurimin e emërimit të kandidatit/es për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës. Qytetarët e Republikës së Kosovës dhe partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, me të drejtë presin funksionalizimin e Qeverisë së re, si dhe presin nga Presidenti të caktojë mandatarin për formimin e Qeverisë.

Si President i Republikës së Kosovës do ta ndërmarr këtë veprim duke ndjekur të gjithë hapat kushtetues, që qytetarët e Republikës së Kosovës të kenë sa më shpejtë Qeverinë e tyre të re,

sidomos në këtë situatë të pandemisë COVID 19, e cila kërkon një qeveri efikase dhe efektive me mandat të plotë kushtetues.

Askush nuk ka të drejtë t'i privojë përfaqësuesit e zgjedhur të popullit në Kuvendin e Republikës së Kosovës për të pasur kandidatin/en për Kryeministër dhe për të ushtruar kompetencën e tij/saj për të zgjedhur Qeverinë e Republikës së Kosovës, siç përcaktohet në nenin 65 (8) të Kushtetutës. Vonesa e juaj në propozimin e kandidatit/es për Kryeministër i pamundëson Kuvendit për të zgjedhur Qeverinë dhe rrjedhimisht pamundëson edhe funksionimin demokratik dhe kushtetues të institucioneve, që sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës duhet ta garantojë Presidenti.

Duke pasur parasysh edhe Pikën 87 të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KO103/14, Gjykata Kushtetuese *“vëren se nuk përjashtohet që partia ose koalicioni në fjalë do të refuzojë të marrë mandatin”*, atëherë duhet ta keni në konsideratë se nëse ju nuk e propozoni kandidatin/en për Kryeministër, atëherë veprimet tuaja mund të reflektojnë edhe hezitim në marrjen e mandatit, respektivisht refuzimin e marrjes së mandatit.

Në fund, kërkoj përsëri nga ju që të bëni propozimin për kandidatin/en për Kryeministër pa humbur kohë dhe në përputhje me nenin 95 të Kushtetutës dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. K0103/14. Unë ju siguroj se brenda një periudhe të arsyeshme kohore, në përputhje me urgjencën për t'i dhënë vendit Qeveri të re me legjitimitet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, do të propozojë kandidatin/en për Kryeministër për të formuar Qeverinë.

Me respekt,


Hashim Thaçi
President i Republikës së Kosovës